



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 11/02/2019

Drejtuar: "ABKONS"

Adresa: Tiranë, Rruga "Themistokli Gërmenji" përballë RTSH, kati II

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur- shërbime**

Numri i referencës së procedurës: **REF-02751-12-28-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Regjistri i fermerëve të Bashkisë Tiranë"**

Fondi limit: 48.587.088,83 (dyzetë e tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e tetë, pikë tetëdhjetë e tre) lek pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj nga data e nëshkrimit të kontratës**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike, Numër 1, Datë 07.01.2019.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "GRAMA" sh.p.k, NIPT J77304712J & "ALBADI" shpk, NIPT J77304720A.**

Vlera totale e ofertës: **45,149,875 (dyzetë e pesë milion e njëqind e dyzetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH**

2. **"ABKONS" sh.p.k, NIPT K61926012O**

Vlera totale e ofertës: **45,671,863.5 (dyzetë e pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre, pikë pesë) lek pa tvsh**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "GRAMA" sh.p.k, NIPT J77304712J & "ALBADI" shpk, NIPT J77304720A.

Përkatësisht për arsye të mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik "GRAMA" sh.p.k & "ALBADI" shpk, nga ku rezultoi se **nuk është në përputhje** me kriteret e percaktuara ne Dokumentat Standarte te tenderit si dhe Kerkesat e vecanta per kualifikim, si më poshtë vijon:

1.1 Operatori ekonomik "GRAMA" sh.p.k pjesë e BOE-së "GRAMA" sh.p.k & "ALBADI" shpk për plotësimin e Pika 2, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ shkronja d:

Nuk ka paraqitur "Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri" pasi vërtetim debie nga Rajoni Burrel rezulton me Kod familjar dhe jo si privat pra në emër të OE. Sipas Ekstraktit të QKB rezulton se OE "GRAMA" ka edhe nje seli te dytë "Vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit: TIRANE "Rruga Don Bosko", Pallati Besa - R, Seksioni B, Shkalla 5, Apartamenti 50" për të cilin "**Nuk ka paraqitur vërtetim** që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për selinë Tiranë"

1.2 Operatori ekonomik "GRAMA" sh.p.k pjesë e BOE-së "GRAMA" sh.p.k & "ALBADI" shpk për plotësimin e "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik/ pika 3.3/ 1. Shërbime të ngjashme të realizuara ka paraqitur:

- Faturë dt. 27.01.2017 shërbim për GEO BRUNA = 3.048.075 lek pa tvsh
- Faturë dt. 25.08.2017 shërbim për GEO BRUNA =2.313.432 lek pa tvsh
- Faturë dt. 20.11.2017 shërbim për GEO BRUNA = 1.721.927 lek pa tvsh
- Kontrata nr.545, date dt. 28/06/2018 lidhur ndermjet QTTB Fushe Kruje & GRAMA= 891.000 lek pa tvsh
- Kontrata nr.591 DT. 13/07/2018 lidhur ndermjet QTTB Fushe kruje & GRAMA= 1.140.000 lek pa tvsh

Totali i shërbimeve të ngjashme të realizuara nga "GRAMA" sh.p.k është **në vlerën 19.114.434 leke pa TVSH, pra nuk permbush kriterin e DST** pika 3.3 Kapaciteti teknik "

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për punë të ngjashme me objektin e prokurimit si mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, realizimin i censuseve, anketimeve, vrojttimeve apo inventarizimeve, preferencialisht në zonat rurale, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit, përkatësisht 19,434,836 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH"

1.2.1 Referuar Akt Marreveshjes per Bashkimin e Operatoreve Ekonomik lidhur mes paleve ne date 22.01.2019, ndarja e realizimit te punimeve do te behet ne raportet 10% ALBADI sh.p.k dhe 90% GRAMA sh.p.k. **Operatori Ekonomik ALBADI sh.p.k nuk ka paraqitur asnje shërbim të ngjashëm në bazë të përqindjes së realizimit që ka marrë persiper në kuader të BOE-se.**

Në këtë mënyrë bashkimi i shoqërive bie në kundërshtim me Kreun VIII, neni 74, ku citohet se: "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se: "Secili prej anëtarëve të

këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Referuar dispozitës ligjore sa më sipër cituar, shoqëria ALBADI shpk duhet të përmbushë këtë kriter në bazë të përqindjes së partneritetit të marrë përsipër për të kryer.

1.3 Bashkimi i operatorëve ekonomikë "GRAMA" sh.p.k & "ALBADI" shpk për plotësimin e "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik/ pika 3/ 3.1 "Duke patur parasysh shërbimin e kërkuar për krijimin e regjistrimit të fermerëve të Bashkisë Tiranë ..." kanë paraqitur si pjesë të stafit një ekip:

(a). 1 (një) Ekspert Kryesor/Menaxher Projekti: "Genti Lame i cili referuar CV rezulton se punon pranë Grama prej 2013, nderkohe nuk figuron ne Listë PAGESA i punesuar prane ketij OE. Ne librezën e punes rezulton se ka fillimin e marrredhenieve te punes prane GRAMA prej 2013 dhe asnje marrredhenie pune tjeter te dokumentuar ne libeze sipas CV. Ka te lidhur nje Kontrate Individuale pune prej 2013 me kohe te plote por nuk figuron aspak ne liste pagesat si i punesuar. Në CV-në e paraqitur rezulton se ka eksperiencë pune prej vitit 2008 si Ekspert Social-Ekonomik pranë ASSA e më tej pranë ABKONS etj, marrëdhënie pune këto të cilat duhet të ishin reflektuar edhe në librezën e punës të paraqitur.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet 1. Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune..."; 2. Librezë pune (*përderisa është i punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa ose në këtë librezë të reflektoheshin marrëdhëniet e punës/ eksperiencat e tjera në përputhje me CV-në) dhe 3. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figuron edhe në listë pagesat e këtij Operatori. Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën e kërkuar** "..... Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune..."

(b). 1 (një) Eksperti i Metodologjisë: 1. Grigels Mucollari, i cili referuar CV rezulton se punon pranë Grama prej 2016. Ne librezën e punes rezulton se ka fillimin e marrredhenieve te punes prane GRAMA prej 2016 dhe asnje marrredhenie pune tjeter te dokumentuar ne libeze sipas CV ne te cilen rezulton se ka qene i punesuar prej 2008 dhe me pas ne 2010 si Drejtor prane MPPT gje e cila duhet te ishte e pasqyruar edhe ne libeze para fillimit te marrredhenieve te punes prane OE GRAMA. Ka te lidhur nje Kontrate Individuale pune prej 2016 me kohe te plote por nuk figuron aspak ne liste pagesat si i punesuar.; 2. Vilson Simoni i cili referuar CV rezulton se punon pranë Grama prej 2016 por nuk figuron i punesuar prane ketij OE. Ne librezën e punes rezulton se ka fillimin e marrredhenieve te punes prane GRAMA prej 2016 dhe asnje marrredhenie pune tjeter te dokumentuar ne libeze sipas CV ne te cilen rezulton se ka qene i punesuar prej 2013 prane TRING etj gje e cila duhet te ishte e pasqyruar edhe ne libeze para fillimit te marrredhenieve te punes prane OE GRAMA. Ka te lidhur nje Kontrate Individuale pune prej 2016 me kohe te plote por nuk figuron aspak ne liste pagesat si i punesuar.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet 1. Të ketë të paktën dy vite eksperiencë profesionale në hartimin e metodologjisë cilësore për vrojtime, anketime, analizë të dhënash, etj...." për G.M dhe/ ose V.S; 2. Librezë pune (*përderisa është i punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa ose në këtë librezë të reflektoheshin marrëdhëniet e punës/ eksperiencat e tjera në përputhje me CV-në) për G.M dhe/ose V.S; dhe 3. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figuron edhe në listë pagesat e këtij Operatori.

Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën e kërkuar** "..... Të ketë të paktën dy vite eksperiencë profesionale në hartimin e metodologjisë cilësore për vrojtime, anketime, analizë të dhënash, etj...."

(c) 1 (një) Ekspert i Cilësisë së të Dhënave: Klorenta Manushi e cila referuar CV rezulton se

punon pranë Grama prej 2016 por nuk figuron e punësuar pranë këto OE. Ne librezën e punës rezulton se ka fillimin e marrëdhënieve të punës pranë GRAMA prej 2016 dhe asnjë marrëdhënie pune tjetër të dokumentuar në librezë sipas CV në të cilën rezulton se ka qene e punësuar prej 2015 pranë AKSK etj gje e cila duhet të ishte e pasqyruar edhe në librezë para fillimit të marrëdhënieve të punës pranë OE GRAMA. Ka të lidhur një Kontratë Individuale pune prej 2016 me kohe të plote por nuk figuron aspak në listë pagesat si e punësuar.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet 1. Të ketë të paktën dy vite eksperiencë profesionale në procesimin e të dhënave, pastrimin e të dhënave, sigurimin e cilësisë, etj.....”; 2. Librezë pune (*përderisa është e punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa ose në këtë librezë të reflekttoheshin marrëdhëniet e punës/ eksperiencat e tjera në përputhje me CV-në) dhe 2. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figuron edhe në listë pagesat e këtij Operatori.

Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën e kërkuar** ”..... Të ketë të paktën dy vite eksperiencë profesionale në procesimin e të dhënave, pastrimin e të dhënave, sigurimin e cilësisë, etj.....”

(ç). 1 (një) Ekspert i Bujqësisë: Qemal Pojana i cili referuar CV rezulton se punon pranë Grama prej 2007. Ne librezën e punës rezulton se ka fillimin e marrëdhënieve të punës pranë GRAMA prej 2007 dhe asnjë marrëdhënie pune tjetër të dokumentuar në librezë sipas CV në të cilën rezulton se ka qene i punësuar prej 1985 si agronom dhe me pas prej 1997 pranë GJELBERIMI shpk etj marrëdhënie pune të cilat duhet të ishin të pasqyruara edhe në librezë para fillimit të marrëdhënieve të punës pranë OE GRAMA. Ka të lidhur një Kontratë Individuale pune prej 2007 me kohe të plote me OE “GARMA” sh.p.k por nuk figuron aspak në listë pagesat si i punësuar pranë këtij të fundit.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet 1. Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë profesionale me kërkimin shkencor, analizën dhe interpretimin e të dhënave si edhe hartimin e raporteve përmbledhëse.....” 2. Librezë pune (*përderisa është i punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa ose në këtë librezë të reflekttoheshin marrëdhëniet e punës/ eksperiencat e tjera në përputhje me CV-në) dhe 2. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figuron edhe në listë pagesat e këtij Operatori.

Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën e kërkuar** ”..... Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë profesionale me kërkimin shkencor, analizën dhe interpretimin e të dhënave si edhe hartimin e raporteve përmbledhëse.....”

(d). 1 (një) Ekspert Programues/IT: Miranda Harizaj e cila referuar CV rezulton se punon pranë Grama prej 2013, por në Listë pagesa figuron vetëm gjatë muajit qershor 2018 10 dite pune. Ne librezën e punës rezulton se ka fillimin e marrëdhënieve të punës pranë GRAMA prej 2013 dhe asnjë marrëdhënie pune tjetër të dokumentuar në librezë sipas CV në të cilën rezulton se ka qene e punësuar prej 1999 si lektore etj, 2007 si Drejtor pranë MPB dhe me pas prej 2016 pranë AMF etj marrëdhënie pune të cilat duhet të ishin të pasqyruara edhe në librezë para fillimit dhe në vazhdim të marrëdhënieve të punës pranë OE GRAMA. Ka të lidhur një Kontratë Individuale pune prej 2013 me kohe të plote me OE “GARMA” sh.p.k por në Listë pagesa figuron vetëm gjatë muajit qershor 2018, 10 dite pune.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet 1. **Eksperti duhet të ketë një eksperiencë punë jo më pak se 5 vite në programim dhe në krijimin dhe dixhitalizimin e databazave** 2. Librezë pune (*përderisa është e punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa ose në këtë librezë të reflekttoheshin marrëdhëniet e punës/ eksperiencat e tjera në përputhje me CV-në) dhe 3. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figuron edhe në listë pagesat e këtij Operatori.

Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën e kërkuar** ”..... **Eksperti duhet të ketë një eksperiencë punë jo më pak se 5 vite në programim dhe në krijimin dhe dixhitalizimin e databazave.....**”

(e). 3 (tre) Ekspertë IT: 1. Julian Plaku i cili referuar CV rezulton se punon pranë ALBADI prej 2016, ka kontrate individuale pune me ALBADI prej 2016 por ne liste pagesa figuron vetem 10 dite i punesuar te GRAMA dhe jo te ALBADI; 2. Nedjan Shabani i cili referuar CV rezulton se punon pranë ALBADI prej 2016 por nuk figuron i punesuar; 3. Livia Mano i cila referuar CV rezulton se punon pranë ALBADI prej 2016 por nuk figuron e punesuar. Te gjithë personat e mesiperm rezulton se kane nenshkruar me OE ALBADI nje kontrate individuale pune me kohe te plote sipas dispozitave te saj, kane paraqitur qe ne CV kane eksperiencia pune por ne Librezat e Punes rezultojne vetem fillim i marredhenieve te punes prane subjektit dhe asnje informacion tjetër lidhur me eksperiencat e tyre te meparshme apo te mevonshme, nderkohe qe ne liste pagesa nuk figurojne te punesuar prane subjektit.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet: 1. Libreze pune (*përderisa janë punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa) dhe 2. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figurojnë edhe në listë pagesat e këtij Operatori.

Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën e kërkuar** ”..... Të kenë eksperiencë profesionale me bazat e të dhënave, komunikimin e sistemeve dhe rrjeteve, transferimin e të dhënave, etj.....”

(f) 1 (një) Ekspert Logjistike/ i Punës në Terren: Mark Lekgjonaj i cili referuar CV rezulton se punon pranë GRAMA prej 2012 por ne liste pagesa figuron vetem 3 dite pune ne qershor dhe 3 dite pune ne korrik. e librezën e punes rezulton se ka fillimin e marredhenieve te punes prane GRAMA prej 2012 dhe asnje marredhenie pune tjetër te dokumentuar ne libeze sipas CV ne te cilen rezulton se ka qene i punesuar prej 2005 si Inxhinier prane GRAMA, 2009 specialist prane MPPTdhe me pas prej 2014-2016 prane ABKONS shpk etj gje e cila duhet te ishte e pasqyruar edhe ne libeze para fillimit te marredhenieve te punes prane OE GRAMA. Ka te lidhur nje Kontrate Individuale pune prej 2012 me kohe te plote me GRAMA por nuk figuron aspak ne liste pagesat si i punesuar.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet 1. 3-5 vjet eksperiencë profesionale në organizimin e operacioneve në terren për mbledhjen e të dhënave, realizimin e vrojtimit, censuseve, etj 2. Libreze pune (*përderisa është i punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa ose në këtë librezë të reflektoheshin marrëdhëniet e punës/ eksperiencat e tjera në përputhje me CV-në) dhe 3. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figuron edhe në listë pagesat e këtij Operatori.

Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën e kërkuar** ”..... 3-5 vjet eksperiencë profesionale në organizimin e operacioneve në terren për mbledhjen e të dhënave, realizimin e vrojtimit, censuseve, etj.....”

(g). 5 (pesë) Supërvizorë/Koordinatorë në terren: 1. Arjola Mazari me eksperiencë Ing Ndertimi; 2. Romir Mazari me eksperiencë per census prane abkons; 3. Doloreza Kllogjeri me eksperiencë si projektues dhe supërvizor punimesh; 4. Miranda Halili me eksperiencë si projektues dhe supërvizorë; 5. Sefer Manreka me eksperiencë si ing.Gjeodet; 6. Barsino Larushku me eksperiencë si supërvizor terreni prej 2014 prane GRAMA dhe Koordinator Projekti TAP por nuk figuron ne liste pagesa te OE GRAMA; 7. Elvan Muca me eksperiencë si supërvizor prane OE GRAMA por nuk figuron ne listepagesa + eksperiencë si koordinator per projektin TAP+ anketues marrëdhënie pune të cilat duhet te ishin të pasqyruara edhe ne libeze para fillimit dhe ne vazhdim te marredhenieve te punes prane OE GRAMA. 8. Grigor Ciko me eksperiencë si supërvizor prane GRAMA prej 2014 por nuk figuron ne liste pagesa.

Nuk vërteton eksperiencën e stafit/ ekipit të ekspertëve nëpërmjet 1. Të kenë të paktën 3 vjet eksperiencë pune. Të kenë përvoja të mëparshme me organizimin e punës në terren për realizimin e censuseve, identifikimin dhe intervistimin si edhe mbledhjen e të dhënave.” për A.M; D.M; M.H; S.M; 2. Libreze pune (*përderisa janë punësuar pranë OE sipas Kontratës së Punës duhet të figuronin edhe në listë pagesa ose në këtë librezë të reflektoheshin

marrëdhëniet e punës/ eksperiencat e tjera në përputhje me CV-në) për R.M; B.L; E.M; G.C dhe 3. Kontratë pune të vlefshme përderisa nuk figurojnë edhe në listë pagesat e këtij Operatori për B.L; E.M; G.C

Për sa më sipër **nuk përmbush kriterin lidhur me eksperiencën** e kërkuar ”..... *Të kenë të paktën 3 vjet eksperiencë pune. Të kenë përvoja të mëparshme me organizimin e punës në terren për realizimin e censuseve, identifikimin dhe intervistimin si edhe mbledhjen e të dhënave.....*”

1.4 Nuk plotëson kriterin “..... *Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

Pra, bashkimi i operatorëve ekonomik GRAMA” sh.p.k & “ALBADI” shpk, nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit dhe Kapaciteti teknik.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpalli të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ABKONS” sh.p.k, me adresë: Tiranë, Rruga “Themistokli Gërmenji” përballë RTSH, kati II, se oferta e paraqitur, **me një vlerë të përgjithshme prej 45,671,863.5 (dyzetë e pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre, pikë pesë) lek pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve, Bashkia e Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tirane, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë 01.02.2019**

Ankesa: **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**